

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### AKTIVITETE

### SENSIBILIZIM



Gjatë takimit me ZRRE dhe ALPEX

#### TAKIMI NDËRMJET PËRFAQËSUESVE TË ERE, RREGULLATORIT TË KOSOVËS (ZRRE) ME PALËT E INTERESIT, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS ALPEX SH.A., DHE TË OST SH.A., "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në kuadër të miratimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të cilat do ti shërbejnë operimit të Bursës së energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë, Enti Rregullator i Energjisë mirëpriti datë 24 nëntor 2022, përfaqësues të Rregullatorit të Kosovës (ZRRE) me të cilët u zhvillua një seancë publike e përbashkët me palët e interesit të të dy vendeve, ndër të cilët mund të përmëndim AAES, AK, FTL, KOSTT, KURUM, KESH, KESKO DEVOLL HYDROPOWER.

([kliko për të lexuar njoftimin e plotë](#))

#### THIRRJE PËR APLIKIM (KONSUMATORË FAMILJARË) PANELE DIELLORE PËR NGROHJEN E UJIT PËR DERI NË 2000 (DY MIJË) KONSUMATORË FAMILJARË

##### NJOFTIM

Agjencia për Eficiençën e Energjisë njofton se nga data 01.11.2022 dhe në vazhdim janë hapur aplikimet për konsumator familjar, aplikimet do të kryhen online në një portal të dedikuar (jo me e-mail).

Me shume informacion ne lidhje me thirrjen për aplikim për konsumatorët familjar lutemi klikoni "Më Shumë"

Lutemi para se të aplikoni njihuni me kriteret në thirrjen për aplikim dhe me hapat që duhen ndjekur te cilat i gjeni në portalin e aplikimit "MANUAL PERDORIMI"

[kliko këtu](#)

Diskutimi i rregullave të tregut të tregut të organizuar të energjisë elektrike janë mjaft të rëndësishme pasi do ti shërbejnë pjesëtarëve të tregut dhe Bursës Shqiptare Alpex për operimin e tregut të një ditë me parë të energjisë elektrike.

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### LICENCIME

### TAP

### ÇMIMI I ENERGJISË



REGULATORY AUTHORITY FOR ENERGY

Autoritetet Rregullatore të Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (ARERA) miratuan së bashku rregullat për fazën e parë detyruese të procesit të rritjes së kapacitetit të Gazsjellësit TransAdriatik (TAP). Procesi drejtohet në koordinim ndërmjet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit fqinjë, TAP, SBAM Rete Gas dhe DESFA, sipas Rregullores (BE) 2017/459. Ai synon shpërndarjen e kapaciteteve rritëse afatgjata në pikat ekzistuese ose të reja të ndërlidhjes (IP) përgjatë gjurmës së TAP dhe do të rrisë vëllimet e gazit të importuar në Europë. (Njoftimi i plotë)

**#GAZSJELLËSITAP**

**KLIKO PËR TU**  
**NJOHUR ME TARIFAT**  
**PERIODIKE FMF**

**ÇMIMI I ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE MBETI I**  
**PANDRYSHUAR**  
**PËR MUAJIN NËNTOR**

Gjatë muajit nëntor Bordi i ERE-s ka zhvilluar gjashtë mbledhje, të cilat kanë rezultuar në njëzet e katër vendimmarrje, ndër to vecojmë licencimin e tre subjekteve në prodhimin e energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike me kapacitet 2MW secila, duke rritur fuqinë prodhuese vendase me 6MW energji të gjelbër, tre subjekteve në tregtimin e energjisë elektrike si dhe një subjekti në furnizimin e energjisë elektrike; vendime në të cilat janë reflektuar çmime të shitjes së energjisë elektrike, si dhe vendime në të cilat janë reflektuar ndryshime të nevojshme si pasojë e bashkëpunimit të vazhduar me partnerët vendas, apo subjekte të licencuara, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Për tu azhornuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare.